



Kundër ngritjes së çmimit të energjisë elektrike

Prishtinë 10 shkurt 2011 - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), fuqimisht kundërshton vendimin e KEK-ut për ngritjen e tarifave të energjisë elektrike. Ky vendim do të ndikojë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve dhe të punëtorëve të Kosovës, ku edhe ashtu po ballafaqohen me inflacion të dukshëm dhe gjendje të rëndë sociale.

Me këtë vendim do të dëmtohet rëndë popullata, punëtoria si dhe ekonomia e Kosovës, e cila edhe ashtu ka pësuar dëme të mëdha financiare si pasojë e reduktimeve të mëdha të energjisë elektrike.

Kjo ngritje e çmimeve nuk do të zgjedh problemet në KEK, por vetëm se do t'i ripërtërij ato dhe do ti rris ato probleme. BSPK-ja nga KEK-u kërkon që ta rishikojnë edhe një herë këtë vendim dhe ta rikthejë në vendimin e mëparshëm.

BSPK përkrah të gjitha shoqatat joqeveritare që kundërshtojnë ngritjen e çmimit të energjisë elektrike.